




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANCIJE  
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE

DEPARTAMENTI I BUXHETIT KOMUNAL / DEPARTAMANT OPSTINSKE BUDZETA / MUNICIPALITY BUDGET DEPARTMENT

<b>DATË/A:</b>	30 Qershor 2008
<b>PËR/ZATO:</b>	Kryetarët e Komunave Drejtorët për Buxhet dhe Financa Drejtorët e drejtorive
<b>ONGA/OD/FROM:</b>	Ahmet Shala, Ministër 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Qarkore Buxhetore 2009/01 për Komunitat Financimi nga grantet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar për buxhetin komunal të vitit 2009

### 1. Qëllimi

Me Qarkoren buxhetore 2009/01 për komunitat ofrohen udhëzimet e para, kalendari kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar të përgatitjes së buxhetit komunal për vitet 2009-2011 sipas Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal (LFPL). Gjithashtu, kjo Qarkore u ndihmon Komunave në procesin e planifikimit buxhetor gjatë muajve të ardhshëm. Pas kësaj qarkoreje do të pasohen qarkore tjera shtesë, sipas nevojës.

Nga ju kërkohet ta shpërndani këtë qarkore me të gjithë stafin e përfshirë në procesin buxhetor të komunës, i cili ju udhëzon të përgatitni kornizën afatmesme buxhetore komunale duke vazhduar me nxjerrjen e qarkores interne buxhetore komunale si bazë për planifikimin e buxhetit komunal 2009.

Kjo Qarkore do të jetë e para në serinë e qarkoreve që do të sigurojnë informata për komunitat lidhur me procesin buxhetor komunal. Kjo do të plotësohet gjithashtu edhe me serinë e programeve trajnuese dhe sesioneve informuese.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e buxhetit në kohën e duhur dhe që është i përgjegjshëm në aspektin fiskal, është thelbësore që të gjitha komunitat të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuar në këtë dhe qarkoret tjera pasuese buxhetore, si dhe në përputhje me dispozitat e aplikueshme të

Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal dhe Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

## **2. Sfondi**

Këto udhëzime janë preliminare dhe mund të ndryshojnë bazuar në punën që po bëhet tani rreth prioritetëve të politikave. Ndryshimet mund të bëhen për shkaqet në vijim:

- Pasqyrimin e ndryshimeve në strukturën e administratës komunale, ashtu siç parashihen me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (ky proces nuk duhet konsideruar si një mundësi për ndryshim të profilit të gjithëmbarshtëm të buxhetit ose për të bërë përshtatje të mëdha në buxhetin komunal.)
- Hyrja në fuqi e Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal (LFPL)
- Ligji për Administrimin e Kufijve të Komunave
- Implikimet e zgjidhjes së Statusit
- Ndikimi i themelimit të Komunave të reja dhe trajtimi i tyre në zhvillimin e buxhetit komunal.

Nëse paraqiten pyetje lidhur me udhëzimet në këtë qarkore, zyrtarët komunal mund të konsultohen me analistët e tyre në kuadër të Departamentit të Buxhetit Komunal në Ministrinë për Ekonomi e Financa (MEF).

## **3. Korniza Afatmesme e Financimit Komunal 2009-2011**

LFPL fut në jetë ndryshime të konsiderueshme në sistemin e avancuar të financimit komunal në kuptim të ndarjes horizontale dhe vertikale.

Aranzhimet komunale në të kaluarën për financimin komunal kanë paraparë grante ndërqeveritare në shumën e 22.5% të të hyrave qendrore buxhetore të projektuara duke i zbritur të hyrat komunale dhe të hyrat qendrore sipas memorandumeve të mirëkuptimit, dhe kanë përfshirë tri lloje të granteve: grantin e përgjithshëm dhe dy grantet specifike për arsim dhe shëndetësi të fiksuara në aspektin nominal.

LFPL merr masa për financimin e shërbimeve komunale me grantet në vijim:

- Granti i përgjithshëm, me sistem të mbyllur të financimit;
- Granti specifik i Arsimit, me sistem të hapur i cili do të financoj koston e ofrimit të nivelit minimal të standardeve në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm; si dhe
- Granti specifik i Shëndetësisë, i cili do të financoj koston e ofrimit të nivelit minimal të standardeve në kujdesin shëndetësor parësor.

Grantet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin të tyre. Shtojca A paraqet parimet kryesore që rregullojnë përcaktimin dhe alokimin e secilit prej granteve qeveritare, të aprovuara nga Komisioni i Granteve për periudhën 2009-2011. Shumat agregate janë prezantuar në Tabelën 1, e mëposhtme të financimit komunal. Përveç kësaj, financimi i shpenzimeve që lidhen me koston e pas statusit për komunat e reja është përfshirë në këta kufij fillestarë.

Tabela 1: Korniza e financimit komunal 2009-2011, milionë euro

	Projeksioni		
	2009 Aprovuar	2010	2011
<b>A. Grantet qeveritare</b>	<b>196.1</b>	<b>202.7</b>	<b>209.1</b>
Granti i përgjithshëm, nga i cili	85.0	90.0	95.0
Komunat e reja	3.5	3.5	3.5
Granti i arsimit, nga i cili:	88.1	89.3	90.3
Shkollat Speciale	1.4	1.4	1.4
Komunat e reja	2.6	2.2	2.2
Granti i shëndetësisë, nga i cili:	23.0	23.4	23.8
Komunat e reja	0.8	0.8	0.8
<b>B. Neto kostoja e statusit</b>	<b>9.3</b>	<b>14.7</b>	<b>6.5</b>
Komunat e reja	6.3	7.7	3.7
Kompetencat e shtuara (Investimet kapitale)	3.0	7.0	2.8
<b>C. Të hyrat vetanake</b>	<b>37.2</b>	<b>38.2</b>	<b>39.2</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>242.6</b>	<b>255.6</b>	<b>254.8</b>

#### 4. Parimet për përgatitjen e buxhetit komunal 2009-2011

##### 4.1 Kufijtë fillestarë të financimit

Komisioni i Granteve ka aprovuar kufijtë fillestarë të financimit komunal për vitin 2009 si dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme 2010-2011, që përfshin grantin e përgjithshëm, grantin specifik për shëndetësi, grantin specifik për arsim, të hyrat vetanake dhe nivelet e stafit e të pagave për secilën komunë. Këta kufij preliminarë janë dhënë në Shtojca B. Në përputhje me strategjinë e MASHT-it për arsimin me nevoja speciale, granti i arsimit është përshtatur për të mundësuar financimin dhe sigurimin e stafit për këtë program në nivel komunal. Komunat do të informohen për alokimet përkatëse të financimit dhe të stafit për këtë program me anë të një qarkoreje të veçantë. **Nga komunat kërkohet të planifikojnë buxhetet e tyre për tri vitet e ardhshme dhe tu përmbahen kufijve të dhënë si në Shtojcën B dhe qëllimit të financimit nga secili lloj i granteve (Shtojca C) si dhe të hyrave vetanake (Shtojca D).**

##### 4.2 Struktura e buxhetit komunal

Struktura për buxhetin komunal është e bashkangjitur në këtë qarkore buxhetore (Shtojca E, tabela C e buxhetit komunal), ku janë bërë harmonizimet e nevojshme në Regjistrat kontabël për të pasqyruar strukturën e re administrative komunale, në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në mënyrë të detajuar janë paraqitur drejtoritë dhe

programet. Komunat nuk obligohen të krijojnë maksimumin e drejtorive bazë të prezantuara në strukturën tabelare buxhetore komunale, mirëpo do të duhej të organizohen në bazë të dispozitave të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, andaj duhen të jenë racionale në krijimin e tyre për ofrim sa më efikas dhe funksional të shërbimeve komunale duke respektuar numrin e të punësuarëve dhe masën monetare në nivelet e aprovuara.

Komunat duhet të respektojnë parimet e kornizës afatmesme buxhetore komunale, buxhetimin programor - planifikimi i buxhetit sipas drejtorive/programeve në pajtim me ligjin e vetëqeverisjes lokale si dhe instruksionet e brendshme buxhetore.

#### **4.3 Vlerësimet e hershme**

Vlerësimet e hershme janë element kyç i përgatitjes së projeksioneve buxhetore për vitin 2009 dhe do të shërbejnë si bazë për vitet 2010 dhe 2011. Vlerësimet e hershme janë veçmas të domosdoshme për shqyrtimin e duhur të shpenzimeve operative dhe atyre kapitale.

Vëmendje paraprake duhet kushtuar kursimeve që mund të identifikohen duke analizuar aktivitetet e përfunduara në vitin (vitet) paraprake e të cilat nuk do të përsëritën në vitin vijues.

Komunat duhet të kenë parasysh gjatë vlerësimeve të hershme:

- Legjislacionin me ndikimet financiare;
- projektet që janë në vazhdimësi të cilat bartin obligime financiare në vitin 2009 dhe vitet pasuese.

#### **4.4 Kufijtë fillestar të shpenzimeve buxhetore**

Në planifikimin e shpenzimeve operative për vitin 2009, komunat këshillohen të bazojnë buxhetet e tyre në nivelet e vitit 2008. Nga kjo del se do të kemi një përcaktim të kufijve të fortë për shpenzimet rrjedhëse për secilën komunë.

Përgjithësisht, në kategorinë e **Pagave dhe Mëditjeve**, rritja në numrin e punëtorëve dhe masën monetare për paga dhe mëditje nuk do të lejohet krahasuar me buxhetin e vitit 2008, me përjashtim për komunat e reja dhe pilot njësitë komunale. Në Shtojcën F janë dhënë kufijtë agregat për paga dhe mëditje dhe stafin për secilën komunë.

Kategoria e **Shpenzimeve kapitale** do të ketë rritje në krahasim me vitin 2008 si rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm. Rekomandohet që niveli i planifikimit në kategorinë e shpenzimeve kapitale për vitin 2009 të jetë të paktën në nivelin e vitit të kaluar, (si financim nga të hyrat vetanake dhe nga grantet), dhe duhet të marrë parasysh rritjen e konsiderueshme në grantin e përgjithshëm (dmth. meqenëse granti i përgjithshëm ka pësuar rritje sipas LFPL, rekomandohet që diferencat rezultuese të destinohen për projekte kapitale). Forma e prezentimit të buxhetit për projektet kapitale është përfshirë në Shtojcën G.

Rekomandohet që gjatë hartimit të projekteve kapitale për vitin 2009, secili projekt duhet të përmbajë edhe pjesën e shpenzimeve operative që është pjesë e atij projekti. Këto projekte duhen të hartohen duke marrë për bazë format elektronike të PIP-it.

Përparësi për financim duhet të kenë ato projekte në vazhdim që janë iniciuar në vitet paraprake dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Komunës të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, Kryetari i Komunës dhe Komiteti për Politikë e Financa të cilat kanë deklaruar arsyeshmëri të plotë për financim. Komunitet duhet të tregojnë se si propozimet e tyre do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e vendeve të reja të punës, ngritjen e mirëqenies së qytetarëve etj.

#### **4.5. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB Komunale)**

Rekomandohet që Komunitet të shfrytëzojnë përvojën nga vitet paraprake dhe të mbështesin procesin e tyre buxhetor komunal për vitin 2009 në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB komunale). KAB Komunale duhet të përcaktojë me sa vijon për tri vitet vijuese fiskale:

- (a) Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore
- (b) Strategjia zhvillimore e komunës
- (c) Vlerësimin agregat të të hyrave nga të gjitha burimet, përfshirë këtu transferet ndërqeveritare, në pajtim me shumën e njoftuara nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, si dhe të hyrat vetanake komunale duke përfshirë edhe participimin e qytetarëve, në pajtim me parashikimet buxhetore që i përmban KAB Komunale
- (d) Caqet agregate (të përgjithshme) për shpenzime në të gjitha drejtoritë sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve
- (e) Vlerësimet e përkrahjes së pritur nga donatorët, donatorët ndërkombëtar dhe agjencionet ndërkombëtare qeveritare, përfshirë bashkëfinancimin nga IPA, etj.

Gjatë zhvillimit të draftit të KAB komunale, komuniteti dhe palët kyçe të përfshira në proces duhet të konsultohen, përfshirë këtu takimet publike për diskutimin e prioritetëve dhe strategjive komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) duhet gjithashtu të mbajë takime publike për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë para aprovimit të këtij dokumenti. Dokumenti i aprovuar i KAB Komunale do të publikohet për të qenë në dispozicion të publikut dhe një kopje t'i dërgohet Departamentit të Buxhetit Komunal në MEF, Shtojca H.

#### **4.6. Buxhetimi për drejtori dhe programe**

Procesi buxhetor komunal i vitit 2009 do të vazhdojë me zbatimin e buxhetimit programor në nivelin e drejtorive dhe programeve. Fokusimi do të jetë mbi objektivat, strategjitë, produktet dhe rezultatet e synuara nëpërmes të procesit buxhetor. Shtojca I ofron formularët për misionin dhe performansën e buxhetit, përfshirë këtu masat e thjeshta të performansës, që komunitet do të duhej të zhvillojnë dhe sigurojnë për secilën drejtori. Duhet të merret parasysh në mënyrë obligative hyrja në fuqi e Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale i cili rregullon strukturën organizative të qeverive lokale duke e detajuar me statutet komunale.

**Buxheti komunal për Kujdesin Shëndetësor Primar (KShP)** për vitin 2009 do të përfshijë një mekanizëm të ri të financimit që synon të sigurojë një bazë më të drejtë dhe më të barabartë për pagesën e KShP. Objektivi është të stimulohet performansa e ofruesve të shërbimeve shëndetësore dhe të inkurajohen përmirësimet në cilësinë, efikasitetin dhe

efektshmërinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Komisioni i Granteve ka vendosur që pagesa e bazuar në performansë do të përbëjë 5% të Grantit total për shëndetësi për secilën komunë. Këto fonde do të jenë të pagueshme në baza tremujore apo gjashtëmujore për komunat, pas arritjes së caqeve të caktuara të performansës. Nëse konstatohet që performansa ka qenë nën apo jashtë cakut të synuar, atëherë komunat rrezikojnë me humbjen e pagesave.

Pasi që pagesa e bazuar në performansë është burim i ri i fondeve për KShP-në, nga komunat do të kërkohet ta paraqesin atë si linjë të veçantë në buxhetin e KShP-së. Për Planin buxhetor 2009, pagesa e bazuar në performansë do të alokohet në këto proporcione: 60% për kategorinë paga e mëditje dhe 40% për kategorinë mallra e shërbime, nën linjën e veçantë buxhetore të quajtur “Programi i performansës”. Fondet për të stimuluar profesionistët shëndetësorë individual dhe për të siguruar mallra e shërbime në KShP, përgjithësisht konsiderohen të rëndësishme në mënyrë që mekanizmi i pagesës të ketë sukses.

Caqet e performansës do të vendosen dhe do të maten në fushat e ndryshme të KSHP-së. Ato do të jenë të thjeshta për tu matur dhe realiste për tu arritur. Treguesit e mëposhtëm janë duke u shqyrtuar: rezultatet e KSHP-së në fushat prioritare të politikave sikur që është shëndeti i nënës dhe fëmijës, programet e imunizimit, zbatimi i fushatave të shëndetit publik & parandalimit të sëmundjeve, etj. Caqet e performansës mund të vendosen gjithashtu në raport me proceset administrative, sikur që është raportimi i saktë dhe në kohë të duhur i të dhënave në Njësinë e Informatave Shëndetësore, veprimi në pajtim me planet e edukimit të vazhdueshëm, apo veprimi në pajtim me normat dhe standardet tjera të MSh-së. Caqet dhe masat e performansës janë duke u testuar aktualisht për të vlerësuar lehtësinë e aplikimit dhe përshtatshmërisë së tyre në katër pilot komuna, dhe tërësia finale e treguesve të performansës dhe metodologjisë për matjen e saj do të jenë në dispozicion deri në shtator 2008.

Detajet tjera të metodologjisë së pagesave të bazuara në performansë do të vihen në dispozicion të komunave së shpejti. Instruksionet specifike do të lëshohen me Qarkoret buxhetore të ardhshme.

Buxhetet komunale për vitin fiskal 2009 do të përgatiten sipas pesë kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Thesari, si vijon: Paga & Mëditje, Mallra & Shërbime, Shpenzime komunale, Subvencione & Transfere dhe Shpenzime kapitale (Shtojca J, kodet ekonomike).

#### **4.7 Programi i Investimeve publike (PIP)**

Komunat këtë vit do të përdorin sistemin elektronik të PIP-it për herë të parë. Sistemi i PIP-it bazohet në formularët të cilët janë përdorur viteve të fundit nga Komunat për arsyetimin e projekteve kapitale. Shfrytëzimi i proceseve të avancuara është i nevojshëm për arsyetim të plotë të buxheteve të projekteve - për të paraqitur problemet aktuale të cilat duhet të adresohen në situatën ekzistuese, për të siguruar se merren parasysh opsionet para-për-vlerë për adresimin e problemeve, për të siguruar planifikim të mirë të projekteve dhe për të parashikuar se sigurimin e kostove për përkrahjen e implementimit të projektit si dhe për kostot periodike pas përfundimit të projektit.

Shfrytëzimi i sistemit është i domosdoshëm për integrimin e proceseve të planifikimit dhe zhvillimit të buxheteve për BKK, për të lehtësuar raportimin dhe prodhimin e raporteve të buxhetit dhe në fund të këtij viti për të raportuar dhe monitoruar implementimin e projektit (dhe ekzekutimit të buxhetit). BDMS-ja nga ky vit e tutje nuk do të lejojë futjen e buxheteve të projekteve kapitale, mirëpo të dhënat nga Sistemi i PIP-it do të ndërlidhen me BDMS-në në mënyrë që projektet të raportohen nga BDMS-ja por të mos futen atje. Prandaj, sistemi i PIP-it duhet të përdoret për zhvillimin e buxhetit të projekteve kapitale.

Projektet shumëvjeçare do të përfshihen në sistem, në mënyrë që nëse një projekt vazhdon më shumë se një vit atëherë hollësitë e projektit të tillë për vitet e ardhshme do të duhet vetëm të shqyrtohen dhe azhurnohen nëse një gjë e tillë kërkohet. Gjithashtu, propozimet e arsyetuara mirë të cilat janë futur në sistemin e PIP-it, mirëpo të cilat nuk mund të përfshihen gjatë përgatitjes së buxhetit aktual, do të mund të ruhen në sistem për t'u marrë parasysh në vitet e ardhshme. Të dy këto iniciativa do të lehtësonin në mënyrë afatgjatë ngarkesën e punës së projekteve kapitale.

Sistemi i PIP-it mund të gjendet në [www.pip-ks.org](http://www.pip-ks.org). Ju tashmë do të duhej të kishit shfrytëzues në sistemin e PIP-it dhe zyrtarë nga secila komunë janë ftuar për trajnim. Trajnimi i hollësishëm për shfrytëzimin e sistemit të PIP-it është duke vazhduar dhe procedurat e plota që shpjegojnë sistemin e PIP-it si dhe futjen e të dhënave mund të gjenden në sistem duke mbajtur kursoren në titullin "Procedurat e PIP-it" të cilat gjenden në pjesën e poshtme të ekranit dhe duke klikuar në udhëzimet relevante të cilat dëshironi të paraqiten.

Sa i përket projekteve të mëdha me vlerë mbi 400,000 euro, ju duhet të formuloni propozimin duke klikuar në shtegun "Identifiko projekt të madh (krijo/edito) - faza 1". Pas plotësimit të kësaj pjese, analistët e buxhetit në MEF do të bëjnë shqyrtimin e projekteve të identifikuara dhe do të ofrojnë reagime në lidhje me atë se ku apo si mund të përforcohet përmirësimi. Pas aprovimit të projekt-propozimit të madh në fazën e 1-rë mund të vazhdohet me punën në fazën e 2-të (buxhetimi i projekteve).

Sa i përket projekteve të vogla nën 400,000 euro dhe për projektet e mëdha të cilat janë aprovuar në fazën e parë atëherë formulimi i propozimit të tyre mund të bëhet duke klikuar në shtegun "Buxheto projekt të madh/vogël (krijo/edito) - faza 2". Pas përfundimit analistët e buxhetit edhe këtu duhet të shqyrtojnë propozimin dhe të ofrojnë reagim se ku apo si mund të përforcohet propozimi.

Pas miratimit të projekteve, shumat e buxhetuara dhe hollësitë e shkurtra të projektit do të futen në BDMS përmes një ndërfaqe të automatizuar.

Ju lutem kontaktoni analistin tuaj të buxhetit ose tavolinën ndihmëse të PIP-it për çfarëdo pyetje në lidhje me procesin dhe sistemin e PIP-it.

#### **4.8. Sistemi për menaxhimin e të dhënave buxhetore**

Sistemi i menaxhimit të të dhënave buxhetore (BDMS) është instaluar dhe është në dispozicion për shfrytëzim nga Komunitat për futjen e buxhetit të Aprovuar për një vit fiskal.

Po qe se është e nevojshme të gjitha Komunave do t'ju ofrohet trajnimi për përdorimin e sistemit, për të siguruar që zyrtarët përgjegjës komunal të kuptojnë si përdoret sistemi. Të gjitha komunat do të obligohen të bëjnë futjen e të dhënave në BDMS në mënyrë të pavarur. Në rastet kur Komunat nuk e shfrytëzojnë sistemin BDMS, do të ndeshen me probleme në sigurimin e fondeve të tyre të buxhetuara.

Nëse keni pyetje apo probleme lidhur me përdorimin e BDMS, inkurajohen të kontaktojnë me analistët e tyre të buxhetit në Departamentin e Buxhetit Komunal, apo me Arjeta Rukovci, administratore e sistemit të BDMS, në e-mail: [arukovci@mfe-ks.org](mailto:arukovci@mfe-ks.org), tel. 038/200 34 233.

## **5. Fazat e procesit buxhetor komunal 2009-2011**

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2009-2011.

### **Hapi 1: Themelimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale**

Ashtu si është rekomanduar në pikën 4.5 më sipër, Hapi i parë në zhvillimin e buxhetit komunal 2009-2011 do të ishte themelimi i Kornizës afatmesme buxhetore komunale (KAB komunale). Ky dokument do të paraqesë vendimet komunale lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve si dhe mënyrën se si do të bëhet alokimi në mes kategorive kryesore ekonomike, për të përmbushur strategjinë zhvillimore afatmesme të komunës.

#### **Veprimi që kërkohen:**

1. Drejtori për Buxhet dhe Financa zhvillon dhe dorëzon nëpërmes të Bordit të Drejtorëve tek Komiteti për Politikë dhe Financa draftin e KAB komunale
2. Konsultimet do të mbahen me komunitetin dhe palët kyçe të përfshira, përfshirë këtu takimet publike për të diskutuar lidhur me prioritetet dhe strategjitë e komunës.
3. Aprovimi nga KPF-ja, publikimi i KAB komunale dhe dorëzimi në Departamentin e Buxhetit Komunal/ MEF

### **Hapi vijues: Përgatitja e vlerësimeve të hershme 2009 nga drejtori i buxhetit dhe financave me asistencën e drejtorive komunale**

Vlerësimi i saktë i kostos së drejtorive/ programeve të aprovuara nga komuna si dhe identifikimi i parametrave që përdoret azhurnimi i tyre shtron nevojën që drejtori për buxhet dhe financa në bashkëpunim me drejtoritë tjera duhet të përgatisë vlerësimet në përputhje me kufijtë e aprovuar buxhetor 2009.

### **Hapi 2: Shqyrtimi i prioriteteve nga Drejtoritë komunale**

Hapi i dytë kërkon nga Drejtoritë që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Programet ekzistuese duhet të vlerësohen në



kontekst të objektivave të gjithmbarshme të komunës dhe strategjive sektoriale që janë zhvilluar. Në pajtim me prioritetet e gjera të Komunës (kur janë në dispozicion), secila Drejtori duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2009-2011 (d.m.th, që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performansë të dobët. Propozimet për shpenzimet e reja kapitale duhet të mbështeten me analizat e përfitimeve dhe kostos së projektit (kur janë në dispozicion) dhe në pajtim me prioritetet e komunës.

Propozimi i politikës së re definohet si kërkesë për fonde për (a) programin e ri (përfshirë këtu projektin e ri kapital dhe legjislacionin e ri që ka implikime); (b) zgjatjet e programeve ekzistuese autoriteti i të cilave është para skadimit; apo (c) zgjerimi i programit ekzistues. Opsioni për kursime mund të jetë (a) reduktimi i propozuar në shpenzime për programin për shkak të efikasitetit të propozuar apo reduktimeve në nivelin e shërbimeve apo (b) anulimi i propozuar i programit që më nuk është i nevojshëm, ka treguar performansë të dobët apo është i prioritetit të ulët.

Shqyrtimi i prioritetëve do t'u mundësojë Drejtorive që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioritetëve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor. Nëse propozimi apo opsioni aprovohet (në parime) nga Komiteti për Politikë dhe Financa të Kuvendit Komunal gjatë këtij procesi fillestar të shqyrtimit të prioritetëve, Drejtorja do të bëjë kërkesën më të hollësishme, si pjesë e dorëzimit buxhetor në fazat e mëvonshme të procesit buxhetor.

### **Veprimet e nevojshme:**

1. Drejtori i drejtorisë për buxhet dhe financa nxjerr Qarkoren buxhetore të brendshme komunale #1 me të cilën ofron instruksionet për kompletimin e shqyrtimit të prioritetëve nga Drejtoritë, deri më 15 Korrik 2008.
2. Nga Drejtoritë kërkohet të përgatisin dorëzimin e shqyrtimit të prioritetëve jo më vonë se më 30 Korrik 2008.
3. Komiteti për Politikë e Financa bën aprovimin e shqyrtimit të prioritetëve deri më 05 Gusht 2008.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa mban takime konsultative me secilën Drejtori të komunës. Qëllimi i këtyre takimeve do të jetë arritja e pajtimit rreth arsyetimeve për programet e reja /iniciativat rreth politikave si dhe kostos indikative. (sikur u tha, në këtë fazë, propozimet e programeve duhet të identifikohen thjeshtë si propozime të "një linje" për t'u mundësuar vendimmarrësve që të bëjnë shqyrtimin e shpejtë të nevojave të shfaqura dhe prioritetëve si dhe për të përcaktuar se cilat projekte duhet të zhvillohen më tej gjatë hapave të ardhshëm.).

### **Hapi 3: Kufijtë fillestarë specifikë për drejtoritë**

Pas marrjes së vendimit nga Komiteti për Politika dhe Financa lidhur me shqyrtimin e prioritetëve, drejtori i buxhetit dhe financave deri më 10 Gusht 2008 duhet të përgatisë dhe të

dorëzojë në Komitetin për Politika dhe Financa dokumentin buxhetor me të cilin përcaktohen kufijtë specifik të shpenzimeve për drejtoritë/programet, për tri (3) vitet e ardhshme fiskale (Kufijtë e brendshëm komunal të shpenzimeve). Kufijtë e tillë të brendshëm të shpenzimeve komunale duhet të jenë në pajtueshmëri me Qarkoren buxhetore të MEF-it.

Komiteti për Politikë e Financa të Komunës bën shqyrtimin dhe aprovimin (ose mosmiratimin dhe ndryshimin) e menjëhershëm të kufijve të tillë të shpenzimeve për komunën. Gjatë shqyrtimit të tij, Komiteti për Politikë e Financa mund të bëjë modifikimin e kufijve e brendshëm komunal të shpenzimeve të propozuara nga drejtori i buxhetit dhe financave, me kusht që modifikimet e bëra të jenë në pajtim me Qarkoren buxhetore.

Drejtori i buxhetit dhe financave duhet të nxjerrë menjëherë qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2 për drejtorët e njësisë funksionale komunale drejtorive/ programeve, me të cilat ofrohen informata dhe instruksione mbi kufijtë e shpenzimeve të zbatueshëm për tri (3) vitet fiskale si dhe për metodologjinë dhe formatet që do të përdoren në përgatitjen e kërkesave buxhetore. Qarkorja e tillë buxhetore duhet të përfshijë:

- (a) Procedurat që do të përdoren nga njësitë funksionale drejtoritë/programet, në përgatitjen e propozim buxheteve të tyre dhe kërkesave për ndarje të mjeteve buxhetore
- (b) Informatat që duhet të prezantohen në kërkesat e tilla buxhetore
- (c) Hollësitë lidhur me formatin në të cilin duhet të përgatiten kërkesat rreth buxheteve të propozuara dhe
- (d) Data deri në të cilën njësitë funksionale drejtoritë/programet duhet të kompletojnë dhe të dorëzojnë tek drejtori për buxhet dhe financa kërkesat e tilla buxhetore

Me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale, do të kërkohet që drejtoritë/programet komunale t'u përmbahen rreptësisht kufijve buxhetorë.

#### **Veprimet e nevojshme:**

1. Kufijtë fillestarë specifik të drejtorive/programeve duhet të përcaktohen deri më 10 Gusht 2008
2. Qarkorja e brendshme buxhetore komunale #2 duhet të shpërndahet menjëherë në të gjitha drejtoritë dhe siguron informata mbi kufijtë specifik të aprovuar për drejtoritë/programet si dhe instruksione për përgatitjen e dorëzimeve buxhetore.

#### **Hapi 4: Dorëzimi i buxhetit komunal sipas drejtorive**

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë mjete përmes të cilave drejtoritë bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Dorëzimi buxhetor duhet të dizajnohet për të thjeshtësuar mbledhjen e informatave dhe rrjedhën e punës së Komitetit për Politikë e Financa. Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme, dhe duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë

propozimet për programet shpenzuese të reja dhe/apo plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Zyrat komunale të tatimit në pronë duhet të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit dhe normave tatimore me qëllim të arritjes së të hyrave të vlerësuara të tatimit në pronë të parapara me buxhet.

#### **Veprimet e nevojshme:**

1. Drejtoritë/programet komunale do të përcjellin materialet e tyre buxhetore tek Drejtori i Buxhetit dhe Financave deri në datën e specifikuar me Qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2.

#### **Hapi 5: Dëgjimet buxhetore**

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2, drejtori për buxhet dhe financa do (i) të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga njësitë funksionale drejtoritë/programet, dhe (ii) do të mbaj seanca dëgjimore me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të drejtorive.

#### **Veprimet e nevojshme:**

1. Drejtori për buxhet dhe financa nxjerr Qarkoren e brendshme buxhetore #3 në të cilën ofrohet orari kohor dhe kërkesat për dëgjimet buxhetore komunale
2. Dëgjimet buxhetore mbahen në muajin gusht 2008.
3. Dëgjimet buxhetore duhet të paralajmërohen me kohë dhe të zhvillohen si dëgjime publike.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa do ti aprovoj Kufijtë Përfundimtar Buxhetor pas shqyrtimit të rezultateve të dëgjimeve buxhetore.

#### **Hapi 6: Kufijtë final buxhetor dhe dokumentacioni buxhetor**

Pas marrjes së miratimit nga ana e KPF-së dhe pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, drejtori i buxhetit dhe financave do të përgatisë dhe dorëzojë para Bordit të Drejtorëve dhe Kryetarit të Komunës buxhetin e propozuar komunal për secilin nga tri (3) vitet vijuese fiskale në formatin që është në përputhje me instruksionet e përfshira në Qarkoren buxhetore të MEF si në listën e dokumenteve për dorëzim të buxhetit dhe në përputhje me vendimet e sjella nga KPF-ja. Drejtori për buxhet dhe financa në të njëjtën kohë bën shpërndarjen e buxhetit të propozuar për njësitë funksionale sipas drejtorive/ programeve, për vitin e ardhshëm fiskal.

#### **Hapi 7: Shqyrtimi i buxhetit komunal**

Kur Bordi i Drejtorëve të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF, Kryetari

i Komunës bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar komunal në Kuvendin Komunal për shqyrtim/diskutim dhe aprovim. Dokumentacioni Përmbledhës i Buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit Komunal dhe opinionit publik gjithashtu do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit. Në këtë dokumentacion përmbledhës buxhetor duhet përfshirë edhe rregulloret komunale që vendosin zonat e vlerësimit dhe normat tatimore, të cilat paraprakisht do të debatohen dhe të aprovohen nga asambljetë komunale. **Lista e dokumenteve obligative buxhetore është e përfshirë në Pakon e Buxhetit Komunal.** Kuvendi Komunal bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi Komunal të organizoj takim special të paralajmëruar në mënyrë adekuate ku kërkohet nga opinionit publik kontributi për të dhënë në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të jetë i mbuluar nga mediat, ndërsa që buxheti publik të adresohet nga Kryetari i Kuvendit Komunal, ndërsa që rekomandohet të jetë ky një takim i hapur me publikun në përputhje me ligjet në fuqi.

#### **Veprimet e nevojshme:**

1. Buxheti komunal dhe informatat përcjellëse do të dorëzohen për aprovim në Kuvendin Komunal, jo më vonë se më **15 Shtator 2008**.
2. Kuvendi Komunal duhet ti organizoj takimet publike të reklamuar mirë me qëllim të sigurimit të kontributit të opinionit publik për shqyrtimin e buxhetit dhe aprovimit të tij.

#### **Hapi 8: Aprovimi i buxhetit komunal nga Kuvendi dhe dorëzimi në MEF**

Posa të jetë aprovuar nga Kuvendi Komunal, Buxheti komunal dhe dokumentacioni përcjellës duke përfshirë edhe rregulloret e tatimit në pronë, do të dorëzohen në Buxhetin Komunal në MEF. Në pajtim me synimin për transparencë dhe përgjegjshmëri fiskale, dokumentet buxhetore do të vihen në dispozicion të publikut.

#### **Veprimet e nevojshme:**

1. Buxheti komunal i aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe i nënshkruar nga Kryetari do të dorëzohet në MEF deri më **30 Shtator 2008**, në kopje fizike dhe në formën elektronike, në tri gjuhë, dhe vendimin zyrtar të aprovuar nga Kuvendi Komunal.

#### **6. Trajnimet dhe informatat plotësuese**

Departamenti i Buxhetit Komunal do të ofrojë trajnime për komunat lidhur me zhvillimin e buxhetit 2009-2011. Trajnimet do të ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të proceseve të reformuara për zyrtarët e buxhetit. Trajnimi shtesë do të përfshijë module më specifike trajnuese për secilën nga fazat kyçe të buxhetit. Orari dhe agjenda për trajnimet përkatëse do të ofrohet komunave nëpërmes të një kumtese tjetër.

## 7. Shpërndarja transparente e Qarkores Buxhetore në nivelet komunale

Autoritetet komunale janë të obliguara ta shpërndajnë këtë Qarkore Buxhetore tek të gjithë zyrtarët komunal të angazhuar në procesin e hartimit të buxhetit, respektivisht anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Drejtorëve të drejtorive. Të gjitha autoritetet komunale janë përgjegjëse për organizimin kohor të angazhimeve dhe aktiviteteve të tyre në përputhje me orarin e hartimit të buxhetit, në mënyrë që ta mbështesin plotësisht përgatitjen e buxhetit, respektimin e udhëzimeve buxhetore si dhe përfundimin dhe aprovimin me kohë të buxheteve komunale.

### SHTOJCAT:

- Shtojca A - Parimet kryesore mbi përcaktimin e shpërndarjes së granteve ndërqeveritare për komunat për vitet 2009-2011
- Shtojca B - Kufijtë fillestar të financimit ndërqeveritar 2009-2011 për komunat
- Shtojca C - Qëllimi dhe strategjia shpenzuese për Grantet ndërqeveritare
- Shtojca D - Formulari për të Hyrat vetanake komunale në 2009-2011
- Shtojca E - Tabela C për Strukturën e Buxhetit Komunal 2009
- Shtojca F - Kufijtë për paga&mëditje dhe staf për vitin 2009
- Shtojca G - Tabela e projekteve kapitale për komunat për vitin 2009-2011
- Shtojca H - KAB Komunale
- Shtojca I - Deklarata për misionin dhe performansën sipas drejtorive
- Shtojca J - Kodet ekonomike
- Shtojca K - Financimi nga donatorët

### Shtojca A

#### Financimi komunal nga grantet ndërqeveritare – Parimet

**Granti i Përgjithshëm** mundëson një shkallë të arsyeshme të stabilitetit në të hyrat komunale, ofron një mjet adekuat për vendosjen e barazisë ndërmjet komunave, duhet të marrë parasysh mundësinë e banorëve të secilës komunë për të patur qasje në shërbimet publike, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunat përkatëse.

Shuma e Grantit të Përgjithshëm është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore, duke përfshirë (i) të hyrat nga shitja e aseteve, (ii) të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, (iii) të hyrat e dedikuara, dhe (iv) të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, nga totali i Grantit të Përgjithshëm, secila komunë do të pranojë një shumë të përgjithshme (paushalle) prej 140,000 € në vit, minus 1€ për kokë banori, ose 0€ për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000. Pjesa e mbetur e Grantit të Përgjithshëm u alokohet komunave në përpjestim me: (i) numrin e popullsisë, (ii) numrin e popullsisë pakicë, (iii) nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakica kombëtare; dhe (iv) madhësia gjeografike.

Popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); numri i popullsisë pakicë me tre përqind (3%); komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%); dhe përmasat gjeografike me gjashtë përqind (6%).

Në mungesë të dhënave demografike të besueshme dhe të përditësuara, paraqet pengesë kryesore për konstatimin e alokimit të saktë të grantit të përgjithshëm. Në mungesë të shënimeve të numrit të popullsisë, LFPL ka legalizuar të dhënat që janë aktualisht në dispozicion: (a) numri total i popullatës sipas hulumtimit të vitit 2001 (të dhënat e njëjta janë përdorur gjatë shtatë cikleve të kaluara buxhetore, prandaj kështu do të sigurohet krahasueshmëria në mes disa viteve), (b) popullata pakicës sipas hulumtimit më të fundit të MAPL-së, (c) madhësia e komunës sipas MAPL-së dhe Entit Statistikor të Kosovës.

**Granti Specifik për Arsim** dhe përcaktimi i shumës së këtij granti bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit sipas LFPL. Granti Specifik për Arsim duhet të financoj nivelin minimal të standardeve të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm dhe duhet të alokohet për komuna në bazë të numrit të regjistrimit të nxënësve dhe standardeve tjera të siguruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Formula e aprovuar për vitin 2009 e mbështet këtë rekomandim përfshirë indikatorët dhe supozimet në vijim:

Alokimi komunal = Pagat për mësimdhënës + Pagat për personel administrativ dhe ndihmës + Mallrat dhe Shërbimet + Kapitallet

**Pagat për mësimdhënës** = numri i mësimdhënësve = (numri i nxënësve shumicë / 21.3) + (numri i mësimdhënësve pakicë = numri i nxënësve pakicë / 14.2) \* paga mesatare (216 euro për nivelin fillor dhe 236 euro për nivelin e mesëm) \* 12 muaj. Shënim: Kjo përfshin përshtatjen për 4 muaj për pushimet e paguara të lehonisë.

Pagat për personelin administrativ = numri aktual i te punësuarve\* paga mesatare (231 euro për nivelin fillor dhe nivelin e mesëm) \* 12 muaj.

Pagat për personelin ndihmës = numri aktual i te punësuarve\* paga mesatare (130 euro për nivelin fillor dhe nivelin e mesëm) \* 12 muaj.

**Mallrat dhe Shërbimet** = Vlera fikse për çdo shkollë për çdo vit (1000 euro për një shkollë filllore dhe 2000 euro një shkollë të mesme) + shuma fikse për secilin nxënës (23 euro për nxënësit e komunitetit shumicë dhe 25 euro për nxënësit e komunitetit pakicë).

**Kapitallet** = shuma fikse prej 7 eurove për çdo nxënës (kapitale minore që përfshinë riparime dhe mirëmbajtje të objekteve shkollore).

**Granti specifik për Shëndetësi** dhe përcaktimi i shumave totale duhet të bazohet në sistemin e hapur të financimit në përputhje me LFPL. Granti specifik i shëndetësisë duhet të financoj minimumin e nivelit të standardeve të përkujdesjes primare shëndetësore dhe duhet

ti alokohet komunave në bazë të popullatës së normalizuar dhe standardeve të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë.

Formula e aprovuar e Grantit të Shëndetësisë për vitin 2009 e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bankën Botërore është marre për bazë metodologjinë e bazuar në numrin e shfrytëzuesve.

Në bazë të performancës si sistem pagesë në shëndetësinë primare është ndarë 5% e shumës totale të grantit të shëndetësisë të shpërndara si shumë individuale për komuna.

Alokimi komunal = Popullata (bazuar në LFPL) \* 2.8 vizita (mesatare) \* 3.5 euro (mesatarja për vizitë; në të ardhmen do të përfshihet edhe diferencimi i moshës sh gjinisë)

## Shtojca B

## Kufijtë e Financimit Komunal për vitin 2009 - Grantet dhe të Hyrat vetanake

Komunat	Granti i Përgjithshëm - 2009	Granti specifik i Arsimit - 2009			Granti specifik i Shëndetësisë - 2009			THV 2009	2009
	Granti i Përgjithshëm	Granti Specifik i Arsimit *	Shkollat Speciale dhe nevojat e veçanta **	Total (Granti specifik i Arsimit dhe Granti për shkollat speciale)	Granti Specifik i Shëndetësisë	5 % e Performancës ***	Total - Granti Specifik i Shëndetësisë (përfshirë 5 % të performancës)	Të hyrat vetanake - 2009	TOTAL FINANCI MI KOMUNAL
Kalkulimet >>	a	b	c	d = b + c	e	f	g = e + f	h	i = a + d + g + h
1 Deçan	1,551,082	1,613,297	-	1,613,297	395,604	19,780	415,385	370,000	3,949,764
2 Dragash	1,722,163	1,242,914	-	1,242,914	342,727	17,136	359,863	270,000	3,594,940
3 Ferizaj	3,862,290	5,406,715	-	5,406,715	1,086,933	54,347	1,141,279	1,914,130	12,324,414
4 Fushë Kosovë	1,320,004	1,486,168	-	1,486,168	329,820	16,491	346,311	650,000	3,802,484
